



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 23.01.2020

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR PRANIMIN E INSTRUMENTIT TË AMENDAMENTIT TË
KUSHTETUTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS, 1986”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23.01.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për pranimin e Instrumentit të Amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Aurora Mara.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Arjan Kraja, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin shpjegues sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Nëpërmjet këtij projektligji synohet pranimin e amendamentit Kushtetues të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (këtu e më poshtë referuar si ILO), për t'iu bashkuar vendeve anëtare të cilat e kanë ratifikuar atë tashmë.

Kushtetuta e ILO-së u hartua në fillim të vitit 1919, ILO ndryshoi Kushtetutën në vitin 1986 dhe për hyrjen në fuqi amendimet kushtetuese duhet të ratifikohen ose të pranohen nga dy të tretat e Shteteve Anëtare të ILO-s, përfshirë së paku pesë nga dhjetë anëtarët me rëndësi kryesore industriale. Ndryshimet në Kushtetutën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës kanë të bëjnë me qëllimet themelore të Organizatës, selinë e përhershme të Organizatës, përbërjen dhe funksionet e organeve të saj kolegjiale, emërimin dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm, dispozitat kushtetuese në lidhje me konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare të punës.

ILO si agjenci e Kombeve të Bashkuara organizohet në format tripalësh, bashkon qeveritë, punëdhënësit dhe përfaqësuesit e punëtorëve të 187 shteteve anëtare dhe ka në qëndër të veprimtarisë së saj promovimin e drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut dhe të punës të njohura ndërkombëtarisht, duke ndjekur misionin e saj themeltar sipas së cilës, drejtësia sociale është thelbësore për paqen universale dhe të qëndrueshme. Sot, axhenda e punës së ILO-s ndihmon në avancimin e kushteve ekonomike dhe të punës që u japin të gjithë punëtorëve, punëdhënësve dhe qeverive një aksion në paqe, prosperitet dhe përparim të qëndrueshëm.

Vendi ynë ka ratifikuar 54 Konventa të ILO-s ku përfshihen: 8 Konventat Themelore, 4 Konventat e Qeverisjes dhe 42 Konventat Teknike. Projektet e tanishme të bashkëpunimit për zhvillimin e ILO përqendrohen në ringjalljen e Këshillit Kombëtar të Punës si një platformë dialogu mbi punën dhe politikat sociale, promovimin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve të punës jashtë gjykatës, shtrirjen e shërbimeve të punësimit publik në grupe vulnerabël dhe përmirësimin e aftësisë së Inspektoratit Shtetëror të Punës për të monitoruar profesionalisht standardet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.

Instrumenti i amendimit Kushtetues të vitit 1986 prek 4 fusha kryesore të Kushtetutës së ILO-s:

1. *Përbërja dhe drejtimi i trupit drejtues të zyrës.* Numri i anëtarëve të trupit udhëheqës sipas Kushtetutës parashikohet të rritet nga 56 në 112, nga të cilët: 56 do t'u jepen përfaqësuesve qeveritarë dhe nga 28 secili përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Ndërkohë, nuk do të ketë më vende të garantuara për shtetet anëtare me rëndësi të madhe industriale. Përbërja e tij parashikohet të jetë sa më përfaqësuese duke pasur parasysh interesat e ndryshme gjeografike, ekonomike dhe sociale brenda tre grupeve përbërëse, megjithatë, pa cenuar autonominë e njohur të këtyre grupeve.

2. *Procedura e caktimit të drejtorit të Përgjithshëm.* Sipas amendamentit të vitit 1986, drejtori i Përgjithshëm do të vijojë të caktohet nga trupi drejtues, por do të miratohet në Konferencën Ndërkombëtare të Punës.

3. *Votimi në Konferencën Ndërkombëtare të Punës.*

4. *Rregullat e procedurës për amendimin e Kushtetutës.* Ndryshimet parashikojnë që amendimet në Kushtetutën e ILO-s të miratohen nga Konferenca me një shumicë prej dy të tretave të votave të paraqitura, dhe të hyjnë në fuqi kur të ratifikohen ose pranohen nga dy të tretat e Anëtarëve të Organizatës.

Që ky amendament të hyjë në fuqi duhet të ratifikohet ose të pranohet nga 125 vende nga totali prej 187 anëtarëve të Organizatës. Një shtet anëtar pranon këto ndryshime nëpërmjet dy instrumenteve, pranim ose ratifikim.

Deri më datë 24 qershor 2019 janë 110 vende të cilat e kanë pranuar apo ratifikuar këtë ndryshim. Kërkohen edhe 15 ratifikime apo pranime nga vendet përkatëse që ky ndryshim të hyjë në fuqi.

Propozimi i këtij projektligji është në përputhje edhe me parashikimet e nenit 18 pika 1 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dispozitë e cila prashikon se: Aderimi/pranimi/miratimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar më parë prej saj, sipas parashikimeve të vetë marrëveshjes.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARI

AURORA MARA

ULSI MANJA